



USHTRIA



Viti i 79-të i botimit Nr. 15 (827971)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 17 prill 2026



SHQIPËRIA NË ZEMËR TË NATO-s: VIZITA ZYRTARE E MINISTRI TË MBROJTJES ERMAL NUFI NË BRUKSEL FORCON ROLIN EUROATLANTIK DHE BASHKËPUNIMIN ME ALEATËT STRATEGJIKË

» faqe 2



SHQIPËRIA DHE ITALIA FORCOJNË PARTNERITETIN STRATEGJIK NË MBROJTJE

Ministri i Mbrojtjes Ermal Nuhi dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gjeneralletenat Arben Kingji, pritën në një takim zyrtar shefin e Shtabit të Forcave të Armatosura Italiane, gjeneral Luciano Portolano. Gjatë takimit dypalësh, u rikonfirmua niveli i shkëlqyer i marrëdhënieve ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë, të ndërtuara mbi besim të ndërsjellë dhe bashkëpunim të qëndrueshëm ndër vite, veçanërisht në fushën e mbrojtjes. Palët vlerësuan partneritetin e ngushtë dhe bashkëpunimin konkret në fusha të ndryshme...

faqe 4



NJË KOMB, NJË ZË: DIASPORA SHQIPTARE MBLIDHET PËR TË ARDHMEN EUROPIANE

Diaspora shqiptare në qendër të vendimarrjes: Mesazh i qartë për të ardhmen. Në kryeqytetin e Shqipërisë, Tiranë, u zhvillua edicioni i katërt i Samitit të Diasporës, një nga ngjarjet më të rëndësishme kombëtare që bashkon shqiptarët nga 38 vende të botës. Samiti u kthye në një platformë të gjerë diskutimi mbi rolin e diasporës në zhvillimin e vendit, forcimin e identitetit kombëtar dhe rrugën e Shqipërisë drejt integritetit në Bashkimi Europian. Diaspora si "urë" mes Shqipërisë dhe botës. Në fjalën e tij, kryeministri Edi Rama theksoi transfor-mimin...

faqe 6



STUDIUESIT NDEROJNË VEPRËN E RIZA DRISHTIT NË 100-VJETORIN E LINDJES

Në ambientet e Muzeut të Forcave të Armatosura, në një atmosferë respekti dhe mirënjohjeje të thellë, u përkujtua 100-vjetori i lindjes së një prej figurave më të rëndësishme të historisë dhe kulturës ushtarake shqiptare – nënkolonel Riza Drishti. Aktiviteti u zhvillua nën kujdesin e drejtorit të muzeut, Nikolin Kotherja, dhe në praninë e zëvendësministres së Mbrojtjes, Pranvera Skana, si dhe të familjarëve, studiuesve dhe historianëve të njohur, të cilët risollën në vëmendje jetën dhe veprën e një personaliteti që la gjurmë të pashlyeshme në historinë shqiptare...

faqe 8



SHQIPËRIA NË ZEMËR TË NATO-s: VIZITA ZYRTARE E MINISTRIT TË MBROJTJES ERMAL NUFI NË BRUKSEL FORCON ROLIN EUROATLANTIK DHE BASHKËPUNIMIN ME ALEATËT STRATEGJIKË

Vizita zyrtare e ministrit të Mbrojtjes Ermal Nufi në selinë qendrore të NATO-s, në Bruksel, përbën një moment të rëndësishëm në forcimin e rolit të Shqipërisë në arkitekturën euroatlantike të sigurisë dhe në konsolidimin e marrëdhënieve me aleatët strategjikë. Kjo vizitë pune, e mbushur me takime të nivelit të lartë dhe diskutime substanciale, rikonfirmoi qartësisht pozicionin e vendit tonë si një kontribuues serioz dhe i besueshëm në kuadër të Aleancës.

Që në fillim të qëndrimit në Bruksel, ministri Nufi zhvilloi një takim domethënës me përfaqësuesin e lartë ushtarak të Shqipërisë në NATO, gjeneralmajor Ilir Xhebexhia, si dhe me personelin ushtarak dhe civil të Përfaqësimit të Përhershëm të Republikës së Shqipërisë.

Në këtë takim, ministri shprehu vlerësimin e tij të lartë për përkushtimin dhe profesionalizmin e treguar nga stafi, duke e cilësuar punën e tyre si një shembull të spikatur të seriozitetit institucional dhe përgjegjësisë kombëtare.

Në fjalën e tij, ai theksoi se përfaqësimi dinjitoz i Shqipërisë në NATO nuk është vetëm një detyrë formale, por një mision i rëndësishëm që kërkon angazhim të vazhdueshëm, kompetencë dhe koordinim të ngushtë me strukturat e Aleancës. "Takimi me personelin tonë në NATO është një moment i veçantë vlerësimi për punën e tyre të përditshme dhe një nxitje për të forcuar më tej rolin e Shqipërisë në këtë organizatë", - u shpreh ministri.



Vizita vijoi me një nga takimet më të rëndësishme të kësaj agjende, bisedën me Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Mark Rutte. Në këtë takim u diskutuan gjerësisht sfidat aktuale të sigurisë në nivel global dhe rajonal, përfshirë kërcënimet hibride, zhvillimet gjeopolitike dhe nevojën për një përgjigje të koordinuar nga vendet anëtare të Aleancës.

Ministri Nufi vuri në dukje se Shqipëria ka dëshmuar në mënyrë të vazhdueshme përkushtimin e saj për mbrojtjen kolektive, duke marrë pjesë aktive në misionet paqeruajtëse dhe operacionet ndërkombëtare të NATO-s. Ai theksoi se vendi ynë jo vetëm që kontribuon me forca dhe kapacitete konkrete, por gjithashtu luan një rol të rëndësishëm si faktor stabiliteti në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Një tjetër pikë kyçe e diskutimit ishte nevoja për të rritur kapacitetet mbrojtëse dhe për të forcuar gatishmërinë



operacionale, në përputhje me standardet e NATO-s.

Në këtë kuadër, mbështetja e aleatëve konsiderohet thelbësore për të përballuar sfidat e reja të sigurisë dhe për të avancuar modernizimin e Forcave të Armatosura.

Në vijim të vizitës, ministri i Mbrojtjes Nufi zhvilloi një takim të rëndësishëm edhe me Kryetarin e Komitetit Ushtarak të NATO-s, Giuseppe Cavo Dragone. Ky takim u fokusua në forcimin e dialogut strategjik dhe në thellimin e bashkëpunimit ushtarak ndërmjet Shqipërisë dhe Aleancës.

Gjatë bisedimeve, vëmendje e veçantë iu kushtua situatës së sigurisë në rajon, veçanërisht rolit të KFOR-it në garantimin e paqes dhe stabilitetit në Kosovë. Ministri Nufi theksoi rëndësinë e pranisë së vazhdueshme të KFOR-it dhe rolin e tij stabilizues në një kontekst ende të ndjeshëm gjeopolitik.



Në të njëjtën kohë, ai nënvizoi rëndësinë strategjike të projekteve infrastrukturore me ndikim rajonal, si Korridori VIII dhe zhvillimi i Porto Romanos. Këto projekte jo vetëm që rrisin ndërlidhjen ekonomike dhe logjistike, por gjithashtu

Përfaqësimi dinjitoz i Shqipërisë në NATO nuk është vetëm një detyrë formale, por një mision i rëndësishëm që kërkon angazhim të vazhdueshëm, kompetencë dhe koordinim të ngushtë me strukturat e Aleancës.

kontribuojnë në forcimin e sigurisë dhe mobilitetit ushtarak në rajon, duke qenë në përputhje me prioritetet e NATO-s.

Në kuadër të diplomacisë së mbrojtjes, ministri Nufi zhvilloi takime edhe me homologë të vendeve aleate, ku spikat ai me ministrin e Mbrojtjes së Kroacisë, Ivan Anušić. Fillimisht në Bruksel dhe më pas gjatë vizitës në Zagreb, dy ministrat diskutuan mbi forcimin e marrëdhënieve dypalëshe dhe zgjerimin e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes.

Bisedimet u përqendruan në çështje me interes të përbashkët, përfshirë paqen dhe stabilitetin në Evropën Juglindore, zhvillimin e kapaciteteve ushtarake dhe rritjen e ndërveprueshmërisë ndërmjet forcave të armatosura. Të dy palët shprehën gatishmërinë për të thelluar bashkëpunimin në industrinë e mbrojtjes, duke e konsideruar atë një sektor me potencial të madh për zhvillim ekonomik dhe strategjik.

Në këtë kontekst, një rëndësi e veçantë iu kushtua deklaratës trepalëshe ndërmjet Shqipërisë, Kosovës dhe Kroacisë, e cila synon të forcojë koordinimin strategjik dhe të nxisë zhvillimin e industrisë së mbrojtjes në rajon. Kjo iniciativë përfaqëson një hap konkret drejt rritjes së bashkëpunimit rajonal dhe integritit më të thellë në strukturat euroatlantike.

Nga ana e tij, ministri kroat Anušić vlerësoi rolin aktiv të Shqipërisë në NATO dhe progresin e saj në procesin e integritit në Bashkimin Evropian, duke e cilësuar vendin tonë si një partner të besueshëm dhe një faktor kyç për stabilitetin rajonal.

Në përmbyllje të kësaj vizite intensive dhe të frytshme, ministri Ermal Nufi theksoi se Shqipëria do të vijojë të mbetet e përkushtuar ndaj vlerave dhe parimeve të NATO-s, duke kontribuar aktivisht në përpjekjet kolektive për ruajtjen e paqes dhe sigurisë. Ai nënvizoi se vetëm përmes bashkëpunimit të ngushtë me aleatët dhe investimeve të qëndrueshme në mbrojtje, Shqipëria mund të përballojë me sukses sfidat e së ardhmes.

Kjo vizitë në Bruksel dhe Zagreb shënon një tjetër hap të rëndësishëm në konsolidimin e rolit të Shqipërisë në skenën ndërkombëtare të sigurisë, duke dëshmuar qartë se vendi ynë është dhe mbetet një partner i denjë dhe i besueshëm në Aleancën Euro-Atlantike.



KATËR AKTE TË RËNDËSISHME MIRATOHEN: FORCOHET ROLI I FORCAVE TË ARMATOSURA NË MISIONET NDËRKOMBËTARE

Në kuadër të angazhimit për forcimin e kapaciteteve mbrojtëse dhe rritjen e rolit të Shqipërisë në operacionet ndërkombëtare, nga Këshilli i Ministrave u miratuan katër akte të rëndësishme, dy prej të cilave lidhen drejtpërdrejt me Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe pjesëmarrjen e tyre në misione ushtarake jashtë vendit.

Këto vendimmarrje përfaqësojnë një hap konkret në mbështetje të zhvillimit dhe modernizimit të mëtejshëm të Forcave të Armatosura, si dhe në përmbushjen e detyrimeve që Shqipëria ka në kuadër të bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë, veçanërisht në strukturat e NATO-s.

Pjesëmarrja në misionet ushtarake ndërkombëtare vijon të mbetet një nga shtyllat kryesore të angazhimit të Shqipërisë në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Përmes këtyre operacioneve, efektivët shqiptarë jo vetëm kontribuojnë në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit global, por gjithashtu fitojnë përvojë të vyer në menaxhimin e situatave komplekse dhe në bashkëpunimin me forcat aleate.

Burime zyrtare theksojnë se niveli i lartë i përgatitjes profesionale të ushtarakëve shqiptarë është një tregues i qartë i standardeve të arritura ndër vite, duke i bërë ata një partner të besueshëm në çdo mision ku marrin pjesë.

Eksperiencia e fituar në këto operacione ndërkombëtare kthehet më pas në një vlerë të shtuar për zhvillimin e



brendshëm të Forcave të Armatosura, duke ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e kapaciteteve operacionale, përmirësimin e trajnimit dhe avancimin e standardeve profesionale.

Këto akte të miratuara konfirmojnë vijimësinë e politikave të mbrojtjes që synojnë një ushtri moderne, të aftë dhe plotësisht të integruar në strukturat euroatlantike, si dhe një Shqipëri gjithnjë e më aktive në garantimin e sigurisë dhe paqes ndërkombëtare.



Përfundon me sukses kursi i avancuar EOD 3+, rriten kapacitetet për asgjësimin e municioneve shpërthyes

Pas më shumë se gjashtë javësh trajnim intensiv, u përmbyll me sukses kursi EOD 3+, niveli më i lartë i kualifikimit për specialistët e Asgjësimit të Municioneve Shpërthyes (EOD), i zhvilluar në Shkollën e Trupës të Komandës Mbështetëse.

Ky kurs i avancuar u realizua në bashkëpunim të ngushtë me specialistë amerikanë, duke sjellë ekspertizë të standardeve më të larta ndërkombëtare në fushën e menaxhimit dhe neutralizimit të rreziqeve nga municionet shpërthyes.

Gjatë trajnimit, efektivët pjesëmarrës përvetësuan njohuri të thelluara teorike dhe praktike mbi identifikimin, trajtimin dhe asgjësimin e mjeteve shpërthyes, duke përfshirë situata komplekse që kërkojnë reagim të shpejtë dhe profesionalizëm të lartë.

Përfundimi me sukses i këtij kursi dëshmon përkushtimin, disiplinën dhe nivelin e lartë profesional të efektiveve të Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët tashmë rrisin ndjeshëm kapacitetet operacionale në përmbushjen e detyrave kombëtare dhe në kuadër të angazhimeve në misionet ndërkombëtare.

Ky kualifikim përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt forcimit të sigurisë dhe rritjes së gatishmërisë së strukturave të specializuara, duke kontribuar drejtpërdrejt në standardizimin dhe ndërveprueshmërinë me partnerët ndërkombëtarë, veçanërisht në kuadër të NATO-s.

Autoritetet ushtarake shprehën vlerësim për të gjithë pjesëmarrësit, duke theksuar se investimi në trajnime të tilla të avancuara mbetet kyç për zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe për përmbushjen me sukses të çdo misioni në shërbim të sigurisë dhe mbrojtjes.



Stërvitja “Eagle Steel”, rritet dërveprueshmëria e trupave shqiptare me aleatët

Efektivët e Regjimentit të Këmbësisë së Jugut (RKJ), pjesë e kontingjentit të VII në misionin eVA në Bullgari, zhvilluan stërvitjen e përbashkët ndërkombëtare “Eagle Steel”, në bashkëpunim me trupa nga Italia dhe Franca.

Kjo stërvitje u fokusua në një sërë elementësh thelbësorë të operacioneve ushtarake moderne, përfshirë operacionet sulmuese dhe mbrojtëse, procedurat e dhënies së ndihmës së parë në fushëbetejë, si dhe trajtimin dhe menaxhimin e civilëve në kushte konflikti.

Përmes këtij aktiviteti, efektivët shqiptarë patën mundësinë të rrisin nivelin e tyre profesional dhe të përmirësojnë koordinimin me forcat aleate, duke forcuar ndjeshëm ndërveprueshmërinë – një element kyç në operacionet e përbashkëta në kuadër të NATO-s. Stërvitja “Eagle Steel” përfaqëson një tjetër dëshmi të angazhimit të Forcave Tokësore të Shqipërisë, për të përmbushur standardet e Aleancës dhe për të rritur gatishmërinë operacionale të trupave shqiptare në misionet ndërkombëtare. Pjesëmarrja aktive në këto stërvitje shumëkombëshe jo vetëm që kontribuon në rritjen e kapaciteteve ushtarake, por gjithashtu konsolidon pozicionin e Shqipërisë si një partner i besueshëm në garantimin e sigurisë dhe stabilitetit rajonal dhe global.



Shqipëria dhe Italia forcojnë partneritetin strategjik në mbrojtje

Ministri i Mbrojtjes Ermal Nufi dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gjenerallejtënant Arben Kingji, pritën në një takim zyrtar shefin e Shtabit të Forcave të Armatosura Italiane, gjeneral Luciano Portolano.

Gjatë takimit dypalësh, u rikonfirmua niveli i shkëlqyer i marrëdhënieve ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë, të ndërtuara mbi besim të ndërsjellë dhe bashkëpunim të qëndrueshëm ndër vite, veçanërisht në fushën e mbrojtjes.

Palët vlerësuan partneritetin e ngushtë dhe bashkëpunimin konkret në fusha të ndryshme, duke theksuar rëndësinë e thellimit të mëtejshëm të bashkëpunimit strategjik për përballimin e sfidave të përbashkëta të sigurisë. Në këtë kuadër, u diskutua për forcimin e kapaciteteve ushtarake, zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe rritjen e angazhimeve të përbashkëta në misionet ndërkombëtare.

Gjithashtu, u nënvizua përkushtimi i përbashkët për përmbushjen e detyrimeve në kuadër të NATO-s, duke e konsideruar bashkëpunimin Shqipëri-Itali një element kyç në garantimin e paqes dhe sigurisë në rajon dhe më gjerë.

Takimi konfirmoi edhe një herë se partneriteti mes dy vendeve mbetet i fortë dhe në zhvillim të vazhdueshëm, me fokus në rritjen e ndërveprueshmërisë dhe forcimin e rolit të përbashkët në strukturat euroatlantike.



Zhvillohet me sukses stërvitja 72-orëshe e GBKL në Bizë

Kompania e Parë e Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë realizoi me sukses një stërvitje intensive 72-orëshe në rajonin e Bizës, në kuadër të stërvitjes “Mburoja e Arbrit 26-01”.

Gjatë kësaj stërvitjeje, efektivët u përballën me skenarë të ndryshëm operacionalë që testuan qëndrueshmërinë fizike dhe psikologjike, aftësitë taktike dhe nivelin e koordinimit në terren. Aktiviteti u fokusua në përgatitjen për situata reale operationale, duke përfshirë veprime të vazhdueshme në kushte të vështira dhe me intensitet të lartë.

Rezultatet e arritura dëshmuuan një nivel të lartë disipline, përkushtimi dhe profesionalizmi nga ana e trupave, duke reflektuar standardet e kërkuara për përmbushjen e detyrave në kuadër të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Kjo stërvitje kontribuon drejtpërdrejt në rritjen e gatishmërisë operationale dhe forcimin e kapaciteteve të njesisë, duke e bërë atë më të përgatitur për përballimin e sfidave të sigurisë, si në nivel kombëtar, ashtu edhe në angazhimet e mundshme ndërkombëtare.



Trajnim i përbashkët me palën italiane: Rritje e aftësive dhe ndërveprimit operacional

Efektivë të Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë zhvilluan një trajnim të përbashkët me palën italiane, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit ushtarak dhe rritjes së kapaciteteve profesionale të personelit. Trajnimi ishte i fokusuar në përmirësimin e aftësive në qitjen precize, si dhe në rritjen e gatishmërisë për veprime në kushte reale operationale. Përmes seancave praktike dhe teorike, efektivët u ushtruan në standardet bashkëkohore të qitjes, kontrollit të zjarrit dhe menaxhimit të situatave taktike në terren. Gjatë zhvillimit të aktivitetit, u realizua një shkëmbim i gjerë eksperience mes palëve, duke trajtuar qasje moderne në taktikat e luftimit, procedurat operative dhe elementët thelbësorë të koordinimit në nivel njësie. Ky bashkëpunim ka synuar jo vetëm rritjen e saktësisë dhe disiplinës taktike, por edhe forcimin e ndërveprimit ndërmjet forcave aleate. Trajnimi përbën një hap të rëndësishëm në drejtim të standardizimit të procedurave dhe përafrimit me praktikatat e NATO-s, duke kontribuar drejtpërdrejt në rritjen e profesionalizmit, gatishmërisë dhe aftësive operationale të efektiveve të Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë. Bashkëpunime të tilla me partnerët ndërkombëtarë mbeten një element kyç në zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve të Forcave të Armatosura dhe në forcimin e ndërveprimit në operatione të përbashkëta.



Diaspora shqiptare në qendër të vendimmarrjes: Mesazh i qartë për të ardhmen

Në kryeqytetin e Shqipërisë, Tiranë, u zhvillua edicioni i katërt i Samitit të Diasporës, një nga ngjarjet më të rëndësishme kombëtare që bashkon shqiptarët nga 38 vende të botës. Samiti u kthye në një platformë të gjerë diskutimi mbi rolin e diasporës në zhvillimin e vendit, forcimin e identitetit kombëtar dhe rrugën e Shqipërisë drejt integritetit në Bashkimi European.

Diaspora si “urë” mes Shqipërisë dhe botës

Në fjalën e tij, kryeministri Edi Rama theksoi transformimin e madh të diasporës shqiptare, duke e cilësuar atë si një forcë që sot nuk përfaqëson më largimin, por shumëfishimin e potencialit kombëtar.

“Shqipëria jeton kudo ku shqiptarët ruajnë gjuhën, kujtesën dhe ndjenjën e përkatësisë kombëtare”, u shpreh kryeministri Rama, duke shtuar se diaspora është kthyer në një urë të fortë bashkëpunimi mes Shqipërisë dhe botës.

Ai nënvizoi se diaspora nuk është më në periferi të jetës kombëtare, por në qendër të saj, duke theksuar rolin e saj në investime, inovacion, arsim dhe zhvillim ekonomik.

Shqipëria e transformuar dhe ftesa për pjesëmarrje

Gjatë fjalimit të tij, kryeministri u ndal edhe te transformimi i vendit ndër vite, duke theksuar rritjen ekonomike, rritjen e turizmit dhe përmirësimin e imazhit ndërkombëtar të Shqipërisë.

Ai kujtoi se vendi ka kaluar nga një periudhë me pak njohje ndërkombëtare në një realitet ku Shqipëria përmendet me interes dhe kuriozitet në arenën globale. Sipas tij, ky ndryshim është reflektuar edhe në shifra konkrete të zhvillimit ekonomik dhe investimeve të huaja.

Rama i bëri thirrje diasporës që të mos jetë vetëm vëzhguese, por pjesëmarrëse aktive në projektin kombëtar, duke investuar në ekonomi, teknologji, arsim dhe administratë publike.

“Ky vend është një kantier i madh transformimesh që ju fton të jeni pjesë e së ardhmes së tij”, - u shpreh ai.



Vota e diasporës, një hap historik

Një nga momentet më të rëndësishme të samitit ishte theksimi i realizimit të votës së diasporës në zgjedhjet parlamentare të vitit 2025, një zhvillim që u cilësua si historik për përfshirjen politike të shqiptarëve jashtë vendit.

Sipas kryeministrit Edi Rama, ky proces e ka kthyer diasporën nga një zë i dëgjuar në një faktor të drejtpërdrejtë vendimmarrës në jetën politike të vendit.

Kryeministri theksoi gjithashtu ndryshimin e imazhit të Shqipërisë në botë, duke deklaruar se vendi nuk identifikohet më me paragjykime apo perceptime negative, por me turizëm, natyrë, mikpritje dhe zhvillim ekonomik.

Ai përmendi rritjen e numrit të turistëve dhe investimeve të huaja, si dhe përmirësimin e shërbimeve publike digjitale, që sipas tij kanë lehtësuar ndjeshëm jetën e qytetarëve dhe diasporës.



Orkestra Frymore e Forcave të Armatosura dhuroi një performancë të jashtëzakonshme artistike në kuadër të aktiviteteve të Samitit të Diasporës



NJË KOMB, NJË ZË: DIASPORA SHQIPTARE MBLIDHET PËR TË ARDHMEN EUROPIANE

Një pjesë shumë e rëndësishme dhe mbresëlënëse e aktiviteteve të organizuara në kuadër të Samitit të Diasporës ishte edhe performanca artistike e Orkestrës Frymore të Forcave të Armatosura. Kjo orkestër, e njohur për profesionalizmin dhe repertorin e saj të pasur, solli një atmosferë solemne dhe emocionuese gjatë aktivitetit.

Gjatë performancës, Orkestra Frymore interpretoi një përzgjedhje të veprave muzikore kombëtare dhe ndërkombëtare, duke ndërthurur traditën shqiptare me elemente moderne. Ajo u shoqërua në skenë nga artistë të ftuar, këngëtarë dhe instrumentistë të njohur, të cilët kontribuan në krijimin e një spektakli të veçantë artistik.

Ky bashkëpunim mes orkestrës dhe artistëve të ftuar shërbeu jo vetëm si një moment argëtues për pjesëmarrësit, por edhe si një simbol i unitetit kulturor dhe shpirtëror të shqiptarëve brenda dhe jashtë vendit. Muzika e interpretuar përcolli emocione të forta patriotike dhe nostalgjike, duke i afruar më shumë pjesëmarrësit me rrënjët dhe identitetin e tyre kombëtar.



Performanca e Orkestrës Frymore të Forcave të Armatosura, la një përshtypje të thellë tek të pranishmit dhe duke theksuar rëndësinë e artit dhe kulturës në forcimin e lidhjeve mes diasporës dhe atdheut.



Mesazhi kryesor i unitetit kombëtar

Në përmbyllje të samitit, një rol të veçantë pati edhe “Mëngjesi i Vëllazërimit”, ku përfaqësues të komuniteteve fetare shqiptare ndanë mesazhe paqeje, harmonie dhe uniteti.

Baba Mondi, përfaqësues të besimit islam, katolik dhe protestant, u lutën për shqiptarët kudo që ndodhen, duke theksuar rëndësinë e bashkëjetesës fetare si një nga vlerat më të forta të shoqërisë shqiptare.

Mesazhet e tyre u fokusuan te dashuria për atdheun, ruajtja e rrënjëve kombëtare dhe forcimi i unitetit mes shqiptarëve brenda dhe jashtë vendit.

Samiti IV i Diasporës në Pallatin e Kongreseve u mbyll me një mesazh të qartë: diaspora shqiptare është tashmë një pjesë thelbësore e së ardhmes së vendit.

Ky event konfirmoi se lidhja mes Shqipërisë dhe diasporës nuk është vetëm emocionale, por edhe strategjike, duke e kthyer atë në një faktor kyç për zhvillimin ekonomik, integritimin european dhe forcimin e identitetit kombëtar shqiptar.



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Identiteti që nuk shuhet: Gjuha shqipe mes historisë dhe së ardhmes

Në historinë e kombeve të vegjël, mbijetesa nuk ka qenë kurrë një proces i rastësishëm. Ajo ka kërkuar sakrificë, vetëdije dhe mbi të gjitha një shtyllë identitare të pathyeshme.

Për shqiptarët, kjo shtyllë ka qenë dhe mbetet gjuha. Dhe askush nuk e ka artikuluar këtë më fuqishëm sesa At Shtjefën Gjeçovi, i cili në një nga thëniet e tij më të pavdekshme deklaronte: **“Mua edhe mund të më vrasin, por Gjuhën dhe Kombin Shqiptar nuk do të mund t’i vrasin kurrë!”**

Kjo fjali nuk është thjesht një deklaratë heroike. Është një filozofi e tërë ekzistence. Është një paralajmërim për rreziqet dhe njëkohësisht një besim i palëkundur në fuqinë e identitetit kulturor. Sot, kur shqiptarët janë më të shpërndarë se kurrë nëpër botë, kjo filozofi merr një dimension të ri, veçanërisht në kontekstin e Samitit të Diasporës që po zhvillohet në Tiranë.

Nga rezistenca fizike te rezistenca kulturore

Në kohën e Gjeçovit, kërcënimi ndaj gjuhës dhe kombit ishte i drejtpërdrejtë: ndalimi i shkollave shqipe, mohimi i identitetit, presioni për asimilim. Ishte një betejë e hapur, ku armiku kishte emër dhe fytyrë.

Sot, sfida është më komplekse dhe më e padukshme. Nuk ka më ndalim të gjuhës, por ka një konkurrencë të fortë nga gjuhë të tjera më dominante globalisht. Nuk ka më censurë të drejtpërdrejtë, por ka një indiferencë të rrezikshme që lind nga komoditeti dhe integrimi në shoqëri të tjera.

Kjo është arsyeja pse thënia e Gjeçovit: **“Gjuha e një kombi s’ka t’ndalun, as nuk mund t’ndalet kurrë”**, duhet të lexohet sot jo si një garanci automatike, por si një detyrim moral. Gjuha nuk ndalet vetë, ajo duhet të mbahet gjallë nga ata që e flasin.

Gjuha si ADN e kombit

Kur Gjeçovi krahason kombin pa gjuhë me diellin pa dritë, ai na jep një nga përkufizimet më të sakta të identitetit kombëtar. Gjuha është më shumë se një sistem komunikimi, ajo është mënyra si një popull mendon, ndjen dhe interpreton botën.

Në çdo fjalë shqipe fshihet një histori, një traditë, një mënyrë jetese. Kur humbet gjuha, nuk humbet vetëm komunikimi, humbet një univers i tërë kuptimesh.

Në këtë kuptim, ruajtja e gjuhës nuk është një akt konservator, por një akt i vetëdijshëm modern. Sepse një komb që nuk ruan gjuhën e tij, rrezikon të bëhet thjesht një statistikë në historinë e globalizimit.

Diaspora, një realitet i ri kombëtar

Diaspora shqiptare sot nuk është më një periferi e kombit, ajo është një pjesë qendrore e tij. Nga Europa në Amerikë, nga Australia në vendet nordike, shqiptarët kanë ndërtuar komunitete të fuqishme, duke kontribuar në ekonomi, kulturë dhe politikë.

Por kjo shpërndarje sjell edhe një sfidë thelbësore: **Si ruhet identiteti në distancë?**

Fëmijët e lindur jashtë Shqipërisë shpesh përballen me një dilemë të heshtur: të jenë pjesë e shoqërisë ku jetojnë, pa humbur lidhjen me rrënjët e tyre. Në këtë proces, gjuha është elementi më i brishtë.

Nëse nuk mësohet që në moshë të vogël, ajo humbet gradualisht. Dhe bashkë me të, dobësohet edhe ndjenja e përkatësisë.

Samiti i Diasporës: Më shumë se një takim simbolik

Samiti i Diasporës në Tiranë nuk duhet parë si një aktivitet ceremonial. Ai duhet të jetë një pikë kthese në mënyrën se si shteti shqiptar dhe vetë shoqëria e konceptojnë diasporën.

Kombi jeton sa jeton gjuha: Mesazhi i Gjeçovit në kohën e Diasporës



Mesazhi kryesor që duhet të dalë nga ky samit është i qartë dhe i fortë: **Ruajtja e gjuhës shqipe është një prioritet strategjik kombëtar.**

Kjo nënkupton politika konkrete: *Mbështetje financiare dhe institucionale për shkollat shqipe në diasporë. Trajnim dhe dërgim mësuesish të kualifikuar*

Krijim platformash digjitale moderne për mësimin e shqipes. Bashkëpunim me prindërit për të nxitur përdorimin e gjuhës në familje. Pa këto hapa, çdo deklaratë mbetet retorikë.

Teknologjia: Kërcënim apo mundësi?

Në epokën digjitale, gjuha shqipe përballlet me një sfidë të re, dominimin e anglishtes dhe gjuhëve të tjera në internet dhe teknologji. Por kjo nuk duhet parë vetëm si rrezik.

Teknologjia mund të jetë një aleat i fuqishëm në ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës:

- *Aplikacione për mësimin e shqipes*
- *Platforma mediatike në gjuhën shqipe*
- *Përmbajtje edukative dhe kulturore online*
- *Inteligjenca artificiale që mbështet shqipen*

Nëse investohet në këtë drejtim, gjuha shqipe mund të fitojë një hapësirë të re dhe të fuqishme në botën digjitale.

Roli i familjes dhe i individit

Institucionet kanë përgjegjësinë e tyre, por beteja për gjuhën fillon në familje. Janë prindërit ata që vendosin nëse fëmijët e tyre do të flasin shqip apo jo. Çdo bisedë në shqip, çdo libër i lexuar, çdo këngë e dëgjuar është një akt i vogël, por i rëndësishëm në ruajtjen e identitetit.

“Gjuha... do të ruhet si një gur i çmuar”, dhe kjo sepse kombi nuk është një abstraksion, ai është shuma e zgjedhjeve të përditshme të njerëzve të tij.

Një komb përtej kufijve

Shqiptarët sot jetojnë në shumë shtete, por gjuha shqipe mund dhe duhet t’i mbajë të bashkuar. Ajo është ura që lidh brezat, territoret dhe përvojat e ndryshme.

Samiti i Diasporës duhet të shërbejë si një platformë për të ndërtuar këtë urë më të fortë, më të qëndrueshme dhe më të vetëdijshme.

Amaneti që vazhdon

Në fund të këtij reflektimi, kthehemi sërish te fjala e Gjeçovit. Ajo nuk është vetëm një kujtim historik, por një udhëzim për të ardhmen.

Po, individët mund të bien. Historia mund të ndryshojë. Por një gjë mbetet e pandryshueshme: **Një komb që ruan gjuhën e tij, nuk zhduket.**

Sot, nga Tirana, mesazhi duhet të jetë i qartë për çdo shqiptar, kudo që ndodhet: Gjuha shqipe nuk është thjesht një trashëgimi për t’u kujtuar, është një detyrë për t’u mbrojtur dhe zhvilluar.

Sepse, në fund të fundit, e ardhmja e kombit nuk vendoset vetëm në tryeza samitesh, por në mënyrën se si ne flasim, mësojmë dhe jetojmë gjuhën tonë çdo ditë.

*Dhe nëse kjo bëhet me ndërgjegje dhe përkushtim, atëherë fjala e Gjeçovit do të mbetet e vërtetë përgjithmonë: **Gjuhën dhe kombin shqiptar nuk mund t’i vrasë askush.***

STUDIUESIT NDEROJNË VEPRËN E RIZA DRISHTIT NË 100-VJETORIN E LINDJES

Në ambientet e Muzeut të Forcave të Armatosura, në një atmosferë respekti dhe mirënjohjeje të thellë, u përkujtua 100-vjetori i lindjes së një prej figurave më të rëndësishme të historisë dhe kulturës ushtarake shqiptare – nënkolonel Riza Drishti.

Aktiviteti u zhvillua nën kujdesin e drejtorit të muzeut, Nikolin Kotherja, dhe në praninë e zëvendësministres së Mbrojtjes, Pranvera Skana, si dhe të familjarëve, studiuesve dhe historianëve të njohur, të cilët risollën në vëmendje jetën dhe veprën e një personaliteti që la gjurmë të pashlyeshme në historinë shqiptare.

Në respekt të kësaj dite, drejtori i muzeut, Nikolin Kotherja përshëndeti:

Të nderuar përfaqësues të Ministrisë së Mbrojtjes, e nderuara zëvendësministre znj. Pranvera Skana, të nderuar familjarë të nënkolonel Riza Drishtit, të nderuar studiues, historianë, kolegë dhe miq të Muzeut të Forcave të Armatosura, është një nder i veçantë dhe një përgjegjësi institucionale e thellë që sot ndodhemi së bashku për të përkujtuar 100-vjetorin e lindjes së një figure të shquar të historisë sonë ushtarake, nënkolonel Riza Drishti. Ky përvjetor nuk është vetëm një datë përkujtimore, por një moment reflektimi mbi një jetë të tërë të kushtuar dijes, shërbimit ushtarak dhe trashëgimisë muzeologjike shqiptare.

Riza Drishti përfaqëson një nga ato personalitete të rralla që arritën të ndërthurin në mënyrë harmonike karrierën ushtarake me kërkimin shkencor. Ai nuk ishte thjesht një oficer i Ushtrisë Shqiptare, por një studiues i palodhur i historisë së armëve, i traditës ushtarake shqiptare dhe një kontribuues i drejtpërdrejtë në ngritjen dhe konsolidimin e muzeologjisë ushtarake në Shqipëri.

Formimi i tij i gjerë akademik dhe ushtarak, i ndërtuar në disa etapa dhe vende, nga Shqipëria deri në akademitë ushtarake jashtë vendit, i dha atij një horizont të rrallë profesional. Kjo e bëri të aftë të kuptonte jo vetëm aspektin teknik të armatimit, por edhe dimensionin historik dhe kulturor të tij.

Në veprimtarinë e tij të gjatë, Riza Drishti kontribuoi në mënyrë të veçantë në dokumentimin, studimin dhe interpretimin e historisë së armëve shqiptare, duke e trajtuar këtë fushë si pjesë të identitetit kombëtar dhe jo thjesht si objekt studimi teknik. Veprat, studimet dhe kumtesat e tij mbeten edhe sot referenca të rëndësishme për studiuesit e historisë ushtarake.

Një nga kontributet më të spikatura të tij është angazhimi në ngritjen e muzeve ushtarake në Shqipëri, ku ai ishte pjesë e grupeve të punës që ideuan, organizuan dhe realizuan ekspozitat muzeore në disa prej institucioneve më të rëndësishme të vendit. Në këtë drejtim, ai solli një qasje moderne për kohën, duke e parë muzeun jo vetëm si një hapësirë ekspozimi, por si një institucion edukimi dhe formimi qytetar.

Po ashtu, nuk mund të lihet pa u theksuar edhe dimensionin i tij shkencor dhe publicistik. Ai ka lënë pas një trashëgimi të pasur me artikuj, studime, fjalorë terminologjikë ushtarakë dhe përkthime, të cilat kanë pasuruar gjuhën dhe terminologjinë ushtarake shqipe. Ky kontribut e vendos atë ndër figurat themelore të zhvillimit të mendimit ushtarak shqiptar të shekullit XX.

Sot, kur Muzeu i Forcave të Armatosura e përkujton këtë figurë, ne nuk bëjmë vetëm një akt nderimi historik, por riafirmojmë edhe misionin tonë për të ruajtur dhe promovuar kujtesën institucionale të ushtrisë shqiptare. Figura si ajo e Riza Drishtit na kujtojnë se forca e një ushtrie nuk matet vetëm me pajisje dhe struktura, por edhe me mendje të ndritura që i japin asaj kujtim dhe identitet.

Në këtë përvjetor të rëndësishëm, shpreh mirënjohjen më të thellë për familjen Drishti, për bijtë dhe trashëgimtarët e tij, të cilët kanë ruajtur me përkushtim kujtimin dhe veprën e tij, duke e bërë atë të aksesueshme për brezat e rinj dhe për studiuesit e fushës.

Po ashtu, një falënderim i veçantë shkon për të gjithë studiuesit dhe historianët që kanë kontribuar në ndriçimin e jetës dhe veprës së tij, duke e vendosur Riza Drishtin në vendin që i takon në historinë e kulturës ushtarake shqiptare.

Në emër të Muzeut të Forcave të Armatosura, dëshiroj të theksoj se figura e nënkolonel Riza Drishtit do të mbetet një nga shtyllat referuese të punës sonë muzeologjike dhe shkencore. Trashëgimia e tij është pjesë e pandashme e kujtesës sonë institucionale dhe kombëtare.

Lavdi jetës dhe veprës së nënkolonel Riza Drishtit!

ZËRAT E STUDIUESVE QË RIKTHEJNË NË KUJTESË NJË FIGURË TË MADHE

Me rastin e 100-vjetorit të lindjes së nënkolonel Riza Drishtit, një vend të veçantë zunë kumtesat dhe fjalët e studiuesve, historianëve dhe bashkëpunëtorëve të tij, të cilët ndriçuan në mënyrë të thelluar dimensionet e shumanshme të jetës dhe veprës së tij.

Përmes analizave, kujtimeve dhe vlerësimeve të tyre, u krijua një panoramë e plotë e një personaliteti që i përket



jo vetëm historisë ushtarake, por edhe kulturës kombëtare shqiptare në tërësi.

Pajtim Ribaj – VEPRA QË NDËRTOI NJË IDENTITET SHKENCOR

Në kumtesën e tij, Prof. Asc. Dr. Pajtim Ribaj solli një analizë të thelluar mbi profilin shkencor të Riza Drishtit, duke e cilësuar atë si një ndër figurat më të kompletuara të kërkimit në fushën e historisë ushtarake shqiptare.

Ai theksoi se Drishti nuk ishte thjesht një studiues, por një ndërtues i një sistemi të tërë referencial në fushën e armëve, armatimit dhe traditës ushtarake shqiptare. Sipas Ribajt, vepra e tij nuk duhet parë vetëm si një kontribut individual, por si një bazë e rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të studimeve albanologjike dhe ushtarake.

Në mënyrë të veçantë, ai ndaloi te metodologjia e punës së Drishtit, duke vënë në dukje disiplinën shkencore, saktësinë dokumentare dhe përkushtimin afatgjatë që karakterizonte çdo botim të tij.

Bernard Zotaj – STUDIUESI QË NDËRTHURI DIJEN ME PRAKTIKËN

Prof. Dr. Bernard Zotaj solli në vëmendje dimensionin praktik të punës së Riza Drishtit, duke e cilësuar atë si një studiues që nuk mbeti vetëm në teori, por e zbatoi dijen në terren. Ai evidentoi faktin se Drishti ishte një nga ata specialistë që ndërtoi ura mes kërkimit shkencor dhe aplikimit konkret në strukturat e ushtrisë dhe institucioneve kulturore. Sipas tij, kjo aftësi e bëri atë një figurë të rrallë dhe të domosdoshme në zhvillimin institucional të vendit.

Zotaj theksoi gjithashtu rolin e tij në hartimin e fjalorëve ushtarakë dhe enciklopedikë, duke e konsideruar këtë një kontribut të jashtëzakonshëm për standardizimin e terminologjisë ushtarake shqiptare.

Andrea Llukani – KUJTESA HISTORIKE DHE DOKUMENTIMI SHKENCOR

Historiani Andrea Llukani u ndal në rëndësinë e dokumentimit që ka lënë pas Riza Drishti, duke e cilësuar



atë një arkiv më vete për historinë ushtarake shqiptare.

Ai theksoi veçanërisht vlerën e ditarit shumëvjeçar të Drishtit, si dhe materialeve të tjera dokumentare që përbëjnë një burim të çmuar për studiuesit e sotëm dhe të ardhshëm.

Llukani vuri në dukje se puna e Drishtit në dokumentimin e armëve, armëtarëve dhe figurave ushtarake shqiptare ka ndihmuar në plotësimin e boshllëqeve të rëndësishme në historiografinë shqiptare.

Ylli Riza Drishti – DIMENSIONI NJERËZOR I NJË FIGURË TË MADHE

Një moment emocional i aktivitetit ishte fjala e Ylli Riza Drishtit, birrit të profesor Drishtit, i cili solli një këndvështrim të brendshëm dhe njerëzor mbi figurën e të atit.

Ai e përshkroi Riza Drishtin si një prind të përkushtuar



dhe një njeri të thjeshtë, por me vlera të mëdha morale dhe shpirtërore. Kujtimet familjare, sipas tij, janë të ndërthurura ngushtë me përkushtimin e tij ndaj dijes dhe atdheut.

Ylli Drishti theksoi se, përtej figurës publike, ai ishte një njeri që jetonte me libra, që punonte deri në orët e vona dhe që e konsideronte dijen si mision jetësor.

BASHKËPUNËTORËT DHE RRJETI I NJË ELITE SHKENCORE

Në kumtesa u përmend gjithashtu rrjeti i gjerë i bashkëpunëtorëve me të cilët Riza Drishti punoi ndër vite, duke përfshirë figura të njohura të shkencës dhe kulturës shqiptare.

Ai bashkëpunoi me personalitete si:

- Aleks Buda
- Skënder Anamali
- Rrok Zojzi
- Gani Strazimiri

Ky bashkëpunim dëshmon se Drishti ishte pjesë e një elite intelektuale që punonte për ndërtimin e institucioneve dhe identitetit kulturor të vendit.

NJË TRASHËGIMI QË VIJON TË JETOJË

Në përfundim të aktivitetit, të gjithë studiuesit ranë dakord në një pikë thelbësore: vepra e Riza Drishtit mbetet një pasuri kombëtare që duhet studiuar, ruajtur dhe promovuar më tej. Kontributi i tij në histori, muzeologji, kërkim shkencor dhe kulturë është një dëshmi e fuqisë së dijes dhe përkushtimit.

NJË MESAZH PËR BREZAT

Zërat e studiuesve dhe bashkëpunëtorëve në këtë aktivitet nuk ishin vetëm një homazh për të shkuarën, por edhe një thirrje për të ardhmen: për të ndjekur shembullin e një njeriu që jetoi për dijen, për vendin dhe për historinë.

Riza Drishti mbetet një figurë që frymëzon, një simbol i punës së palodhur, i dijes së thellë dhe i dashurisë për atdheun. Për të njohur më shumë këtë figurë të rëndësishme të Artit Ushtarak, **Prof. Asoc. Dr. Zaho Golemi** për lexuesin e shtypit ushtarak sjell kumtesën e tij:



Riza Drishti - FIGURA QË I DHA DIMENSION KOMBËTAR MUZEOLOGJISË

Riza Drishti erdhi në jetë në një mjedis arbëror me rrënjë nga antikiteti ilir i shqiptarëve. Vetë mbiemri Drishti e vërteton këtë, si një nga vendbanimet më të hershme ilire.



Kushdo që ka jetuar epokën e gjysmë shekullit të kaluar ka ndeshur me një emër të nderuar e të respektuar, Riza Drishti, jeta dhe aktiviteti i të cilit përbënin një mision të heshtur, por mjaft rezultativ. Ai ka kryer një veprimtari pasionante për historinë ushtarake, për armët dhe armëtarët shqiptarë, për muzetë, për kulturën dhe muzeologjinë në përgjithësi. Është mjaft i njohur si personalitet ushtarak, kërkues shkencor dhe muzeolog, me interesa të gjera në 21 fusha të ndryshme. Riza Drishti ka shkuar përtej “normës së pushpallur” të kujtimeve, duke i vetëshkruar e vetëdokumentuar ato si rrallëkush, edhe në veprën “Ditari im” (1941–1996), në 3672 faqe.

Riza Drishti, në shënimet e përmbledhura biografike, shkruan se “është lindur në Shkodër, më 16.4.1926, dhe munda të arsimohej, pasi babai i kishte vdekur më 19.2.1931”. Rizai ka kryer shkollën fillore “Hadraj” (1931–1937) dhe “Rus-Haslikaj” (1937–1939). Për të blerë librat e shkollës dhe fletoret, shiste gazetat e kohës, “Drita” dhe “Shtypi”. Në vitet 1938–1942 ndoqi studimet në Liceun e Shtetit të Shkodrës, që dikur quhej Gjimnazi i Shtetit. Më 18 tetor 1942 u nis nga Durrësi për në Brindisi me vaporin “Città di Catania”, një udhëtim i lodhshëm prej 10 orësh. Nga Brindisi u drejtua për në Milano me tren, në Komandën e Shkollës Ushtarake në “Corso Italia”, nr. 12, pranë katedrales “Il Duomo” dhe teatrit “La Scala”. Mësimet i filloi më 22.10.1942 deri më 10.12.1942. Për shkak të bombardimeve, Shkolla Ushtarake e Milanos u transferua në një qytet të vogël të Lombardisë, në Kremona, ku vijoi studimet deri më 10.7.1943, në një jetë ushtarake me disiplinë dhe rregull.

Dy muaj pas fitores mbi nazifashistët, më 12.2.1945, dërgohet për studime në Akademinë Ushtarake të Beogradit, në Jugosllavi, ku do të vijonte studimet e ndërprera në Itali. Më 2.3.1945, filluan studimet dyvjeçare në Beograd, ku kishte vetëm të rinj pjesëmarrës në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare. Më 5 shtator 1945, fillon ristrukturimi i Akademisë në Shkollë Ushtarake të Këmbësorisë dhe, nga 58 studentë shqiptarë, 11 prej tyre u caktuan për t’u specializuar në shkollë të ndryshme ushtarake të BRSS-së, ndër ta edhe Riza Drishti. Kështu, më 13 prill 1946, u nis me tren nga Beogradi për në Bashkimin Sovjetik dhe, pas 10 ditësh udhëtimi, mbërritën në Moskë e më pas në Tula, ku më 29 prill 1946 filloi studimet në Shkollën Teknike Ushtarake të Armëve. Në Tula u specializua si teknik për armët e këmbësorisë nga 23.4.1946 deri më 23.3.1948. Pushimet pas shkollës së Tulës (ish BS), i kaloi në Shkodër, por pa i përfunduar mirë, më 16.4.1948, me radiogram, përmes Garnizonit të Shkodrës, u njoftua të paraqitej pranë Komandës së Artilerisë të MMP-së, ku shërbeu nga 16.4.1948 deri më 7.2.1962, plot 14 vjet. Në strukturat e mbrojtjes kreu edhe kursin njëvjeçar të Shkollës së Partisë pranë Degës Politike të Ministrisë së Mbrojtjes Popullore në Tiranë, në vitet 1950–1951. Riza Drishti kujton me konsideratë të lartë periudhën e studimeve në Universitetin Shtetëror të Tiranës, në Fakultetin Histori-Filologji, në degën e historisë, që zgjatën 4 vjet (1.9.1957 – 28.6.1961), ku u diplomua “Mësues historie për shkollat e mesme”. Kjo diplomë nuk i shërbeu për mësuesi, por për kulturë të përgjithshme dhe për historinë ushtarake e muzeologjinë.

Detyra e kërkoi dhe Riza Drishti, i mirë pajisur me dije dhe disa diploma, shërbeu në Komandën e Artilerisë në Ministrinë e Mbrojtjes Popullore, në Degën e Armatimit të Ushtrisë Popullore. Falë kulturës së gjerë dhe njohjes së gjuhëve të huaja si italisht, rusisht, serbokroatisht, si dhe njohurive në anglisht, frëngjisht, gjermanisht dhe latinisht, u shndërrua në një personalitet të padiskutueshëm dhe një oficer të kërkuar.

Në vitet 1948–1975 shërbeu në disa struktura, si Komanda e Artilerisë e MMP-së, Komanda e Forcave Ushtarako-Detare, Instituti i Studimeve dhe Kërkimeve Ushtarako-Shkencore dhe Shtëpia Qendrore e Ushtrisë Popullore në Tiranë. Funkcionet e tij kanë qenë të larmishme dhe me përgjegjësi të lartë, duke dëshmuar profesionalizëm dhe përkushtim të rrallë.

Por, përpara se të ishte ushtarak i përkushtuar dhe punonjës i denjë i kulturës, Riza Drishti ishte një familjar model. Siç shprehet i biri i tij, Ylli Drishti, ai ishte një baba i drejtë, i qetë dhe shembullor, që përcolli vlera të forta si ndershmëria, përkushtimi dhe dashuria për atdheun.

Specialist i apasionuar i muzeumeve dhe një vlerë e shtuar e kulturës shqiptare

Një dimension i rëndësishëm i figurës së tij është kontributi në muzeologji. Riza Drishti ishte pjesë e grupit të historianëve që realizuan shumë muze kombëtarë dhe

ushtarake në Shqipëri. Ai kontribuoi në ngritjen e 72 muzeve ushtarakë dhe ishte bashkëpunëtor në hartimin e fjalorëve ushtarakë enciklopedikë.

Në fushën shkencore, ai botoi artikuj dhe libra të rëndësishëm si “Armët dhe armëtarët shqiptarë” (1976), si dhe studime të tjera me vlerë për historinë ushtarake shqiptare. Ai identifikoi figura të rëndësishme historike me origjinë shqiptare dhe dha kontribute të çmuara në albanologji dhe muzeologji.

Dituria si forcë jetësore

Riza Drishti jetoi në “mbretërinë e dijes”, duke mishëruar përkushtimin ndaj shkencës. Ai botoi kumtesa në shumë vende të botës dhe përktheu 31 libra nga gjuhë të ndryshme. Biblioteka e tij përmbante mbi 1700 libra në disa gjuhë.

Ai ishte gjithashtu mësimdhënës dhe kontribuoi në edukimin ushtarak dhe civil. Për punën e tij u nderua me disa çmime dhe vlerësime.

Punonjës shkencor dhe bashkëpunëtor i elitës shkencore

Në Institutin e Studimeve dhe Kërkimeve Ushtarake, ai bashkëpunoi me studiues të njohur dhe dha kontribut në hartimin e studimeve strategjike dhe historike. Më pas u angazhua në projektet për ngritjen e muzeve kombëtare, duke qenë pjesë e komisioneve me figura të shquara të shkencës shqiptare.

Ai kontribuoi në krijimin e muzeve të rëndësishëm si Muzeu Kombëtar i Armëve në Gjirokastrë, Muzeu Historik Kombëtar dhe Muzeu i Skënderbeut në Krujë.

Trashëgimia dhe përjetësia e veprës

Riza Drishti ishte një figurë e përkushtuar që nuk kërkoi lavdi, por la pas një trashëgimi të pasur shkencore dhe kulturore. Ai ishte një personalitet i rrallë, që e pa profesionin si mision dhe jetoi me disiplinë, përgjegjësi dhe dashuri për vendin.

Kontributi i tij në historinë ushtarake, muzeologji dhe kulturë mbetet një pasuri e çmuar kombëtare. Ai është një figurë që meriton nderim të përhershëm si një nga përfaqësuesit më dinjitozë të dijes dhe kulturës shqiptare.



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Midis dhunës dhe dinjitetit: Çfarë na mëson historia e Catherine Dior për gratë shqiptare sot.

